



**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO TENNIS FEDERATION**

Në bazë të paragrafit 13.3 të Statutit të Federatës së Tenisit të Kosovës të datës 24 nëntor 2018,
Bordi i Federatës miraton këtë:

RREGULLORE

PËR

TURNETË MASTERS

VERSIONI 1.2



PËRMBAJTJA

1.	Përkufizimet	2
2.	Qëllimi	2
3.	Rregullat e Përgjithshme	2
4.	Shpërblimet dhe shpenzimet	4
5.	Pikëzimi	4
6.	Datat dhe lokacioni	5
7.	Dispozitat përfundimtare dhe të tjera	5

VERSIONET E DOKUMENTIT

Versioni	Në fuqi	Aprovoi / Data e aprovimit	Ndryshimet
1.0	18.10.2019	Bordi / 18.10.2019	-
1.1	15.11.2019	Bordi / 15.11.2019	3.13 Dy tenistë të kualifikohen tutje nga secili grup. 5.3 Pikët penalizuese jo fikse por varësisht grupmohës 5.4 Pikët penalizuese jo fikse por si përqindje e pikëve nën 5.3.
1.2	01.01.2020	Bordi / 15.01.2019	5. Format i ri dhe tabelar i pikëve dhe ndëshkimeve 5.1. Rritet dallimi në pikët që fiton kampioni, finalisti, gjysmëfinalisti për turnetë me 8 tenistë 5.2. Pikët lidhen me gjysmëfinalistin për turnetë me 4 tenistë 5.3. Pikët e ndëshkimit paraqiten në formë tabelare



1. Përkufizimet

Komisioner	Komisioni i garave, ose Komisioneri i Garave (kur nuk ka Komision), ose Sekretari (kur nuk ka Komisioner)
Federata	Federata e Tenisit e Kosovës
Viti	Viti kalendarik

2. Qëllimi

- 2.1. Qëllimi i turneve “Masters” është që të mbahen turnetë përmbyllës të një viti, në të cilin ballafaqohen drejtpërdrejt tenistët më të mirë të atij viti, dhe shpallen Kampionët e Republikës së Kosovës në Tenis për grupmoshat përkatëse.
- 2.2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat në bazë të të cilave organizohen dhe mbahen turnetë “Masters”.

3. Rregullat e Përgjithshme

- 3.1. Të gjitha dispozitat e kësaj rregulloreje vlejné për të dyja gjinitë: femrat dhe meshkujt.
- 3.2. Të drejtë kualifikimi kanë vetëm tenistët të cilët:
 - a. Janë shtetas të Kosovës;
 - b. Gjatë vitit kanë marrë pjesë në së paku një (1) turne zyrtar të Federatës në grupmoshën përkatëse.
- 3.3. Tenistët që kualifikohen, nuk paguajnë kotizim për pjesëmarrje në turne.
- 3.4. Turnetë mbahen për grupmoshat juniorë {U12, U14, U16, U18} dhe kategorinë “A” në të cilat gjatë vitit kanë marrë pjesë shtatë (7) ose më shumë tenistë.
- 3.5. Formati i garave është me dy seta deri në 6 gema (TB7) të fituar, përpos për grupmoshën U12 ku seti i tretë vendimtar është i formatit Super Tie-Break (10).
- 3.6. Garat mbahen në formatin Round Robin (secili me secilin) me nga katër (4) tenistë në një grup. Orari i meçeve përcaktohet si në vijim:
 - a. Xhiro 1 (RR1): T₁ kd T₄ dhe T₂ kd T₃;
 - b. Xhiro 2 (RR2): T₁ kd T₃ dhe T₂ kd T₄;
 - c. Xhiro 3 (RR3): T₁ kd T₂ dhe T₃ kd T₄.

- 3.7. Numri i tenistëve që kualifikohen dhe numri i grupeve në turnetë “Masters”, përcaktohet varësisht numrit të pjesëmarrësve në turnetë zyrtarë të Federatës të grupmoshës përkatëse gjatë vitit, si në vijim:

Pjesëmarrës gjatë vitit	Kualifikohen	Grupe RR
0 - 6	Nuk mbahet	Nuk mbahet
7 - 16	4	1
> 16	8	2

- 3.8. Tenistët kualifikohen automatikisht (plotësojnë pozitat në turne) - sipas rankimit zyrtar (pikët e fituara gjatë vitit në turnetë që merren parasysh për ranking) në fuqi në mesditën e ditës së martë të javës kur mbahet turneu.
- 3.9. Në rast se ndonjëri nga tenistët e kualifikuar për pjesëmarrje, qoftë nuk e konfirmon pjesëmarrjen në kohë qoftë tërhiqet para se ta ketë luajtur meçin e parë, vendi i boshatisur do t'i ofrohet tenistit të radhës në ranglistë.
- 3.10. Së paku 15 ditë para fillimit të turneut, Komisioneri i njofton tenistët e kualifikuar automatikisht, si dhe tre tenistë rezervë, për lokacionin dhe datat kur mbahet turneu. Tenistët duhet ta konfirmojnë pjesëmarrjen, gjegjësisht gadishmërinë për të qenë rezervë, së paku 7 ditë para fillimit të turneut.
- 3.11. Kur garat mbahen në dy grupe, shpërndarja e tenistëve nëpër grupe bëhet me short, duke filluar nga dy të kualifikuarit me rankimin më të lartë, e deri tek dy të kualifikuarit me rankimin më të ulët.
- 3.12. Në përcaktimin e radhitjes përfundimtare në grup konsiderohen këto elemente:
- Nëse njëri tenist nuk i luan të gjitha meçet në grup, meçet e zhvilluara të atij lojtari nuk do të merren parasysh kur krahasohen plasmanet e tenistëve të tjerë në grup;
 - Prioritet në radhitje ka tenisti me: (1) më shumë fitore; (2) më shumë meçe të kompletuara; (3) dallim më të favorshëm të setave të fituar kundrejt atyre të humbur; (4) dallim më të favorshëm të gemave të fituar kundrejt atyre të humbur; dhe (5) fitues në përballje direkte;
 - Në rast se pika b. sipër nuk e përcakton fituesin e grupit, tenistët përkatës do të luajnë Super Tie-Break (10 pikësh) deri sa nuk caktohet fituesi.
- 3.13. Në rastet kur turneu mbahet me dy grupe, dy të parët e grupeve luajnë së pari në gjysmëfinale (fituesi i grupit të parë kundër të dytit në grupin e dytë, dhe e kundërta) dhe fituesit e gjysmëfinaleve ndeshen në finale për ta caktuar fituesin e turneut. Në rastet kur turneu mbahet me vetëm një grup, fituesi i grupit shpallet edhe fitues i turneut.
- 3.14. Fituesi i turneut shpallet “Kampion i Republikës së Kosovës në Tenis” për vitin dhe grupmoshën përkatëse.



4. Shpërblimet dhe shpenzimet

- 4.1. Për turnetë “Masters” në grupmoshat junior jepen shpërblime simbolike jo monetare sipas mundësive dhe sponsorizimeve eventuale.
- 4.2. Për turneun “Masters” në kategorinë “A” jepen shpërblimet e parapara me Rregulloren për “Financat, Procedurat dhe Rregullat”.
- 4.3. Pjesëmarrësit që udhëtojnë nga komuna të tjera nga ajo ku mbahet turneu, do të kompensohen deri në tridhjetë euro (30€) për shpenzimet e udhëtimit.

5. Pikëzimi

- 5.1. Pikët në turneun Masters me 8 tenistë pjesëmarrës, gjegjësisht me dy grupe, janë si në vijim:

	Kampioni i pamposhtur	Fitorja në finale	Fitorja në gjysmëfinale	Fitorja në grup	Mos-paraqitja
U12	26.25	8.75	7.00	3.50	-13.15
U14	37.50	12.50	10.00	5.00	-18.75
U16	75.00	25.00	20.00	10.00	-37.50
U18	7.50	2.50	2.00	1.00	-3.75
A	18.75	6.25	5.00	2.50	-9.90

- 5.2. Nëse turneu realizohet me 4 tenistë (një grup) atëherë pikët për fitore në grup do të jenë të barabarta me pikët e fitores në gjysmëfinale sipas tabelës nën paragrafin 5.1 sipër.
- 5.3. Tenisti që e ka konfirmuar pjesëmarrjen dhe pa ndonjë arsye objektive nuk paraqitet në turne, penalizohet me pikët për mosparaqitje të dhëna në tabelën nën paragrafin 5.1 sipër, dhe humb të drejtën në shpërblim.
- 5.4. Tenisti që pa ndonjë arsye objektive nuk e zhvillon cilindo nga meçet individuale, penalizohet me diskualifikim nga turneu, humbje të shpërblimit, si dhe:

	Meç të pazhvilluar në grup	Finale të pazhvilluar
U12	-4.00	-10.50
U14	-5.70	-15.00
U16	-11.30	-30.00
U18	-1.10	-3.00
A	-3.00	-7.90



6. Datat dhe lokacioni

6.1. Datat e turneve Masters janë fike dhe mbahen sipas afateve në vijim:

Java 42:	U18
Java 43:	U14
Java 44:	U12
Java 45:	U16
Java 46:	Kategoria “A”

6.2. Për të qenë nikoqir i turneve klubet / organizatorët duhet të aplikojnë tek Komisioneri së paku një muaj para se të fillojë turneu. Në mungesë të aplikacioneve (ose aplikacioneve të suksesshme), Komisioneri do të vendos mbi lokacionin ku do të mbahen turnetë.

6.3. Lokacionet mund të jenë të ndryshme për grupmosha të ndryshme, por jo edhe për gjinitë e së njëjtës grupmoshë.

7. Dispozitat përfundimtare dhe të tjera

7.1. Kjo Rregullore shfuqizon të gjitha vendimet dhe rregulloret apo dispozitat e rregulloreve të tjera të Federatës që janë në kundërshtim me të.

7.2. Interpretimi përfundimtar i kësaj Rregulloreje është kompetencë e Bordit.

7.3. Kjo Rregullore vlen për ciklin 2019 e tutje të turneve “Masters”.



Mejdi Rexhepi
Kryetar
Federata e Tenisit e Kosovës